



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL

*I përmbledhur<sup>1</sup>*

Tiranë, më 14.12.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

#### Rendi i Ditës:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), vijon mbledhjen, sipas rendit të ditës të datës 11.12.2020, në lidhje me diskutimin dhe miratimin e listës përfundimtare të renditjes, si dhe raportin përkatës, të cilat do të dërgohen më pas pranë organit të emërtesës.....

#### Marrin pjesë:

- |                      |                    |
|----------------------|--------------------|
| 1. Vitore Tusha,     | (zëvendëskryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji, | (anëtare)          |
| 3. Arta Marku,       | (anëtare)          |
| 4. Miranda Andoni,   | (anëtare)          |
| 5. Saida Dollani,    | (anëtare)          |
| 6. Ludovik Dodaj,    | (anëtar)           |
| 7. Fatjona Memçaj,   | (anëtare)          |

#### Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

1. Avokati i Popullit, përfaqësuar me autorizim nga **Enio Haxhimihali**.

#### Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

### KËSHILLI VIJON MBLEDHJEN

**Vitore Tusha** hap mbledhjen, e thirrur ditën e premte, në datën 11.12.2020, ku janë trajtuar çështjet e parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të rendit të ditës, por edhe pjesa më e madhe e pikës 8 të rendit të ditës. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Anëtarët janë të gjithë të pranishëm, kurse Avokati i Popullit përfaqësohet me autorizim nga Enio Haxhimihali.

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika 1, shkronja "d", neni 232, pika 2, neni 242, shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED-së për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED-ja disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhjeje, sipas ligjit.

Sqaron se Këshilli, pasi ka bërë pikëzimin dhe renditjen për kandidatin e lejuar, ka vijuar me pikëzimin dhe renditjen e tij. Në këtë mbledhje Këshilli vijon mbledhjen e thirrur ditën e premte dhe është paraqitur nga relatorja projektvendimi për vlerësimin e kandidatit që konkretizon pikët që ky Këshill i ka dhënë, si dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes dhe i raportit përkatës. Projektraporti u është përcjellë anëtarëve dhe të ftuarve. Fton anëtarët të miratojnë projektvendimin e paraqitur nga relatorja në lidhje me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e tij.

I jep fjalën zonjës Dollani.

**Saida Dollani** merr fjalën: “Dëshiroj të vë në dukje vetëm një gjë, që pasi jua kam përcjell juve në momentin e fundit para se të vij këtu, në pikën 67 ka një ndryshim në projektakt, është çështje fjalësh, nuk është çështje pikësh. Kështu është zëvendësuar fjala “këshilltar” me “prokuror”. Kjo është në terma të përgjithshëm. Kjo do të pasqyrohet, ky ndryshim në vendim dhe në përgjithësi unë kam ardhur me projektakt vendimi. Është përpara jush, në rast se keni pyetje apo dëshironi, po them në mënyrë *eksplicite* jam e gatshme për ta bërë.”

**Vitore Tusha** pyet nëse ka ndonjë pyetje apo mendim ndryshe.

**Anëtarët** miratojnë vendimin për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen për kandidatin e lejuar Altin Binaj.

**Vitore Tusha** sqaron se në listën përfundimtare dhe raportin përkatës është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur për këtë vakancë, që në shpalljen e saj fillestare më 28.08.2018 dhe rishpalljen më 21.08.2019 dhe më 24.09.2020. Sqaron se në lidhje me këtë vakancë është informuar organi i emërtesës për situatën dhe se është marrë në konsideratë edhe vullneti i organit për ta dërguar me këtë kandidat të vetëm. Opinioni i të gjithë anëtarëve të Këshillit, rishpallja disa herë, koha e gjatë që ka kaluar, mandati i shkurtër dhe elemente të tjera që janë diskutuar, e gjithë procedura e ndjekur është bërë pjesë e këtij raporti dhe janë përshkruar.

Pyet nëse anëtarët kanë ndonjë sugjerim për të shtuar ndonjë element tjetër në raport.

**Anëtarët** shprehen se janë dakord me raportin dhe nuk kanë gjë për të shtuar. Raporti miratohet.

**Vitore Tusha** fton të miratohet edhe lista përfundimtare, e cila është me një kandidat. Kjo listë miratohet nga Këshilli dhe përcillet si akt i rëndësishëm që duhet të shoqërojë këtë praktikë dhe procedurë.

**Anëtarët** miratojnë listën përfundimtare të renditjes.

**Vitore Tusha** pyet nëse përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, Kryetarit të Kuvendit dhe Presidentit kanë ndonjë koment në lidhje me procedurën e ndjekur?

**Përfaqësuesit** e institucioneve shprehen se nuk kanë komente.

**Vitore Tusha** deklaron të mbyllur mbledhjen dhe informon se gjatë ditës Këshilli do t'i përcjellë administrativisht Kuvendit aktet e miratuara.

**Tiranë, më 14.12.2020, ora 12:12**

**Zv/KRYETARE**

**Vitore TUSHA**

**ANËTARE**  
**Fiona PAPAJORGJI**

**ANËTARE**  
**Arta MARKU**

**Zv/ KRYETARE**  
**Vitore TUSHA**

**ANËTARE**  
**Ludovik DODAJ**

**ANËTAR**  
**Saida DOLLANI**

**ANËTARE**  
**Miranda ANDONI**

**ANËTAR**  
**Fatjona MEMÇAJ**

**SEKRETARE**

**Ermelinda KADIU**

**Vilma DOKUSHI**